



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:261967
Datë: 08.03.2024
Numri i dokumentit: 05429046

C-IV.-14-7030

B G nga Prishtina.

Kundër:

Ankuesi:

E paditura:

N.SH “Banka Themelore e Kosovës”, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit,** rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrije Shala, me dt.06 mars shkurt 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

1.REFUZOHET si e pa bazuar ankesa dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.PRN125-0003 i dt.21 tetor 2014.

2.Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me dt.13 nëntor 2014, ankuesi ish punëtor i NSH “Banka Themelore e Kosovës” ka ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovë (më tej “Dhoma e Posaçme”) kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (më tutje AL) nr. PRN125-0003 i dt.21 tetor 2014, me të cilin ka kërkuar kompensim për paga të pa paguara për periudhën prej vitit 1990 në shumë të pa caktuar. Ankesën e paraqet për shkak të zbatimit të gabuar të dispozitave materiale. Ankuesi në ankesë ka deklaruar se ka AKP e ka zbatuar gabimisht nenin 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar, dhe se nuk ka pasur mundësi ti realizoj të drejtat e veta nga baza e

marrëdhënies së punës dhe të kërkoj realizimin e pagave të pa paguara për shkak të masave të dhunshme. Ankesës i ka bashkangjitur Kopjen e vendimit të atakuar.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj lënde me dt.14 nëntor 2023 ka lëshuar një urdhër për ankuesin, përmes të cilit ka kërkuar që të bëjë precizimin e shumës së kërkuar, si dhe të bëjë dorëzimin e kopjes së njoftimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës, kopjen e librezës së punës, kopjen e listës së pagave dhe prova të tjera shtesë në mbështetje të pretendimeve ankimore. Ankuesi e ka pranuar këtë urdhër dhe me dt.23 nëntor 2023 dhe deri në kohën e përpilimit të vendimit nuk i është përgjigjur të njëjtit.

Me dt.08 shkurt 2024 e paditura AKP-ja ka parashtruar mbrojtje në ankesë, në të cilën pohoi se objekt i kësaj procedure është vetëm ligjshmëria e vendimit të AL. Ankuesi nuk tregoj se cilin nen e ka shkelur AL me rastin e marrjes së vendimit, prandaj vendimi nuk bie në kundërshtim e asnjë dispozitë ligjore dhe nuk ka bazë për të shfuqizuar vendimin. Rrjedhimisht ankesa është e pa bazuar dhe e parashkruar konform dispozitave ligjore. Ka kërkuar që kërkesëpadia të refuzohet si e pa bazuar.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par.2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësata apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa par.3 parasheh se palët që pretendojnë një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse palët e tilla dështojnë që të paraqesin apo dorëzojnë provat e tilla, atëherë vlerësohet se palët nuk kanë përmbushur barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (ei incumbit probatio qui dicit).

Në këtë rast gjykata gjen se, nuk është kontestues fakti se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, por nga shkruesat e lëndës gjykata vie në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmojë se i takon kompensimi për paga të pa paguara nga viti 1990 në shumë të pa precizuar. Ankuesi ka dorëzuar vetëm kopjen e vendimit të kundërshtuar dhe ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të ankesës së tij edhe pas parashtrimit të urdhërit të dt.14 nëntor 2023, duke zgjedhur që të mos i përgjigjet të njëjtit. Vetëm kopja e vendimit të kundërshtuar, të cilin ankuesi e ka dorëzuar së bashku me ankesë nuk dëshmojnë se ankuesit NSH-ja i ka mbetur borxh.

Nga kjo gjykatë vjen në përfundim që parashtruesi i ankesës nuk i ka përmbushur kriteret themelore të ankesës. Ankuesi do të mund të dorëzonte prova relevante në mbështetje të pretendimeve të tij ankimore, siç janë dokumentet me anë të së cilave do të dëshmonte se sa vite ka punuar tek e paditura, se sa e ka pasur lartësinë e pagës mujore, dhe listën e pagave të cilat ankuesi pretendon se ndërmarra i ka mbetur borxh për periudhën prej vitit 1990. Aq më pak ankuesi nuk e ka bërë precizimin e shumës të cilën e kërkon nga e paditura. Por i njëjti e ka pranuar urdhrin e lëshuar nga gjykata me dt.16 janar 2024, dhe nuk i është përgjigjur të njëjtit. Gjykata gjen se, në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara nga viti 1990, nuk janë të mbështetura në provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do t'i bart shpenzimet e veta procedurale.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga data e pranimimit. Ankesa duhet të parashtrohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r j a
Hajrije Shala